

VENDIM
Nr. 422, datë 4.7.2012

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË
KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS,
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË
MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:
 - a) Në shkronjën “a” të pikës 1/3 shtohet emërtesa “Drejtoria e Shifrës”;
 - b) Pas pikës 4/11 shtohet pika 4/12, me këtë përmbajtje:
“4/12. Në Drejtorinë e Shifrës, nëpunësit në pozicionet “përgjegjës sektori” dhe “specialist”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.”.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara tashmë për Drejtorinë e Shifrës dhe të fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha